

KONTRATË DHURIMI

Sot, më datë 09.09.2022, në përputhje me Nenin 761-772 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Nenit 73 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), nënshkruajnë këtë kontratë palët e mëposhtme:

PALA E PARË:

BLERINA LEGISI, atësia Neim, amësia Fluturake, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në TIRANË, me adresë E Kosovarëve; Nd. 1; H. 6; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 5; lindur më 14/01/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036815621 dhe nr. personal 1351141790., e cila për efekt aktmarrëveshje do të njihet si "DHURUESI"

PALA E DYTË:

LORENC LEGISI, atësia Nikoll, amësia File, shtetas Shqiptar, lindur në Rrëshen, Mirditë dhe banues në TIRANË, me adresë Dajti 03900024; Nd. 36; H. 8; Ap. 18; Dajt; lindur më 17/09/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032733111 dhe nr. personal H60917048K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila për efekt aktmarrëveshje do të njihet si "PËRFITUESI"

Kjo Kontratë nënshkruhet duke marrë në konsideratë kushtet para-kontraktore ("PREMISAT") si vijon:

- §1 Dhuruesi është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë tregtare "DELTA ING" Sh.p.k., shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS: **L51923514A**, me seli Selë në Tiranë në adresën: Rruga "Gjik Kuqali", Nr.pasurie 5/64641-14, Zona Kadastrale 8270, Vol.69, Faqe 69, Sip. 62.5 m², me objekt të veprimtarisë së saj: "Nderime civile, import eksport, tregti mallrash të ndryshme, prodhime materiale ndertimi, agjensi imobilare, etj", regjistruar në Qendren Kombëtare të Bisnesit më datë 16/07/2015 (në vijim "SHOQËRIA");
- §2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Dhuruesit, me vlerën ALL 8.077.600,00 (tetë million e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind lekë), e përbërë nga 1 (një) kuotë;
- §3 Më datë 09.09.2022, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e Shoqërisë, përfaqësuar nga Dhuruesi ka marrë vendim për dhurimin e kuotës në favor të Përfituesit;
- §4 Palët kanë vullnet të sanksionojnë efektet e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë përmes marrëveshjes kontraktore.

Në vijim të Premisave të kësaj Kontrate (të cilat janë pjesë përbërëse dhe integrale e këtij akti), palët bien dakord si vijon:

Neni 1 – Objekti dhe legjislacioni i zbatueshëm



1. Palët bien dakord se kjo Kontratë rregullon marrëdhënien juridiko-civile të dhurimit, për një pjesë të të drejtave reale mbi pronësinë e Shoqërisë, të cilat Dhuruesi do t'i kalojë në favor të Përfituesit.
2. Për interpretimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate, palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2 – Dhurimi

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Dhuruesit do t'i dhurojnë Përfituesit, pa kundërshtim, 100 % (njëqind përqind) të kuotave që zotërojnë në Shoqëri.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, kapitali themeltar i Shoqërisë do të zotërohet nga Përfituesi në masën 100% (njëqind përqind).
3. Palët bien dakord se kjo Kontratë do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin tregtar për Shoqërinë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga nënshkrimi i saj.
4. Me regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Dhuruesi nuk do të ketë më asnjë tagër disponimi mbi kuotën e Shoqërisë.
5. Përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, Dhuruesi ka bërë me dijeni Përfituesin për të gjitha të drejtat (kreditë) dhe detyrimet (debitë) e Shoqërisë, të cilat do të merren përsipër nga Përfituesi në vijim, në tërësinë e tyre.

Neni 3 – Të ndryshme

1. Palët bien dakord se të gjitha korrespondencat ndërmjet tyre do të kryhen përmes postës elektronike, në adresat e parashikuara në pjesën hyrëse të kësaj Kontrate.
2. Palët bien dakord se të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate do t'i referohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 4 – Të fundit


1. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të bëhet me shkrim, me pëlqimin e të dyja palëve dhe i bashkangjitet në formë Aneksi, marrëveshjes egzistuese.
2. Palët bien dakord dhe marrin përsipër që, në rast se ndonjëra prej dispozitave të kësaj Kontrate do të konstatohet si absolutisht apo relativisht e pavlefshme, apo do të jetë në kundërshtim me ligjin ose do të bëhet e pamundur për t'u zbatuar, kjo nuk do të sjellë pavlefshmëri absolute apo relative, paligjshmëri apo pamundësi të zbatimit të neneve të tjera të kësaj Kontrate.
3. Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.
4. Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje, secila me të njëjtën përmbajtje dhe vlerë juridike, nga dy kopje të së cilës mbahen nga palët.
5. Për çka nuk është parashikuar këtu, palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në fuqi.

PALËT

DHURUESI
BLERINA LEGISI

PËRFITUESI
LORENC LEGISI

Blerina Legisi




Lorenc Legisi
